

**AWA****(Albanian Woman in Audiovisual)**

Kthim përgjigje kërkesës së datës 3.09.2018

Mendim për vlerësimin e projekteve në QKK

Drejtuar Kryetarit të QKK: Z. Ilir Butka

I nderuar zoti Kryetar, së pari më lejoni t'ju falenderoj për këtë iniciativë të ndërmarrë nga institucioni që Ju drejtoni. E konsideroj një domosdoshmëri të kohës hapjen dhe diskutimin mbi këtë argument delikat, i cili do të vendosë vijueshmërinë dhe suksesin e filmave shqiptarë në të ardhmen. Në vijim të shkresës së marrë nga Ju datë 03.09.2018 me objekt: Mendim mbi vlerësimin e projekteve pranë QKK, ju lutem gjeni më poshtë mendimin dhe sygjërimet e shoqatës AWA.

**1. Anëtarët e KMP-ve mund të jenë edhe personalitete apo profesionistë me shtetësi të huaj? PO/JO**

Në rast se përgjigja do të jetë PO, atëherë duhen zgjidhur dy probleme:

- a. mbulimi i kostos së udhëtimit dhe akomodimit kur anëtari i KMP është i huaj;
- b. përkthimi i skenarëve në gjuhën angleze.

**Argumentimi:**

Pjesa më e madhe e kineastëve shqiptarë që kanë të njëjtën njohje si profesionistët e huaj në fushën e kinematografisë, nuk mund të jenë pjesë e komisioneve përzgjedhëse për shkak të konfliktit të interesit sepse ata thuhetse gjithmonë duhet të paraqesin veprat e tyre në KMP. Afati prej 2 vitesh i komisionit përzgjedhës e bën thuhetse të pamundur pjesëmarrjen në KMP të kineastëve aktivë. Profesionistët e huaj që do të ishin pjesëmarrës në KMP për përzgjedhjen e projekteve filmike më të mira shqiptare do të ndihmonin:

- a. Qasjen ndërkombëtare të projektit. Shoqatat e kineastëve si organizma të cilat propozojnë antëtarët e KMP, shpesh gjenden në vështirësinë e

përzgjedhjes së tyre, kjo pasi konflikti i interesit nuk mund të lejojë Producentë, Regjisorë, Skenaristë aktivë, të marrin pjesë në KMP. Shpesh komisionet të përbërë nga anëtarë vendas, kanë qasje të mangët në vlerësimin, gjykimin dhe koherencën e projektit, si dhe sfidat ndërkomëbtare, me të cilat përballet kinemaja shqiptare. Një profesionist i huaj, i cili nuk ka konflikte interesi dhe zhvillon aktivitetin e tij jashtë Shqipërisë do të mundësojë vlerësimin të projekteve një qasje me universale, si dhe një gjykim më të ftohtë me sfidat që do të përballet vepra e ardhshme. Sot veprat filmike në të gjithë Evropën realizohen në bashkëpunim, për më tepër që ky është një imperativ për realizimin e veprave tona filmike si për arsye pragmatiste, buxhetet e ulëta, por edhe rritjes së kualitetit artistik të veprës së ardhshme filmike, në rang botëror.

- b. Për shkak të eksperiencave të mëdha në përzgjedhjen e projekteve, profesionistët e huaj vlerësojnë më mirë aspektin global të veprës në të gjithë komponentët, që nga zhvillimi i projektit, cilësia e veprës, produksioni, trupa artistike dhe realizueset, por mbi të gjitha distribucioni ndërkombëtar një hallkë e dobët në përmbjlljen me sukses të veprës filmike shqiptare.
- c. Shpesh profesionistët e huaj janë pjesë përzgjedhëse edhe në komisione të tjera ndërkombëtare veprash filmike, ndaj ata me njohjet që kanë mund të ndihmojnë, promovojnë veprat shqiptare të konkurrojnë me sukses edhe në konkurse ndërkombëtare. Pjesëmarrja e anëtarëve të bordit me shtetësi të huaj, do të mundësojë shfrytëzimin maksimal të vlerave dhe individëve me të suksesshëm evropianë në KMP.
- d. Për të gjitha arsyet e sipërpërmendura, mendojmë se mundësimi i anëtarëve të KMP me shtetësi të huaj do të ndihmojë në rritjen e cilësisë së përzgjedhjes së projekteve.

Përsa i përket pikave a. dhe b. mendojmë se këto shpenzime duhet ti mbulojë QKK në këmbim të cilësisë së përzgjedhjes së projekteve që sjell një strategji e tillë. Ose të merret shembulli i QKK-së të Kosovës. Kjo e fundit ka një eksperiencë disa vjeçare në përfshirjen e anëtarëve me shtetësi të huaj në KMP, ndaj mendojmë se referenca ndaj zgjidhjes së kësaj problematike mund të jetë ajo e QKK-së Kosovë.

## **2. A duhet bërë vlerësimi i projekteve me pikë PO/IO**

Po, vlerësimi duhet bërë me pikë sepse:

- a. Aktualisht KMP vlerëson projektet me votim të fshehtë nga antaret, të cilët rendisin projektet në një listim sipas numrit të projekteve të paraqitura. Kjo mënyrë votimi ka një bazë thellësisht subjektive, e cila lë vend për shumë diskutime dhe pakënaqësi. Për të rritur nivelin e objektivitetit dhe meritokracisë në përzgjedhjen e projekteve të ardhshme filmike mendojmë se votimi me pikë do të ishte një njësi matëse e cila ul ndjeshëm diskutimin subjektiv mbi përzgjedhjen e projekteve. Kjo nuk do të thotë se nuk do të ketë pakënaqësi dhe se nëpërmjet këtij votimi do të zgjidhen të gjitha problematikat, por premtori një sistem meritokracie të matshme.
- b. Argumenton në një aspekt më të gjërë të projektit, që nga skenari, vepra e mëparshme e regjisorit dhe suksesin e saj në festival dhe publik, zhvillimin e projektit, kapacitetin e produksionit që merr persiper realizimin e veprës.
- c. Shmang subjektivitetin në vlerësimin e një projekti dhe e bazon atë në fakte objektive të matshme.

**3. A mendoni që janë të rëndësishëm dhe duhet të përfshihen në vlerësimin që anëtarët e KMP-ve do t'i bëjnë projekteve filmike, elementët e mëposhtëm:**

- I. Cilësia e filmit të mëparshëm të regjisorit, që përbëhet nga këto elementë:
  - a. Audiencia në salla në kinematë shqiptare;
  - b. Pjesëmarrja në festivale të filmit të mëparshëm;
  - c. Çmimet që ka fituar filmi i mëparshëm.

**Argumentitmi:**

- a. Po duhet të përfshihen sepse: nëse filmi ka pasur audiencë në salla do të thotë që vepra komunikon me publikun, që produksioni ka qënë i aftë ta shpërndajë veprën dhe të bëjë një marketing të mirë për të dhe të dyja këto përbëjnë garanci për veprën e ardhshme. Në këtë pikë duhet të përcaktohet dysHEMEJA e biletave të shitura në salla e veprës së mëparshme të regjisorit, si dhe mekanizmat e verifikimit të audiences.
- b. Pjesëmarrja në festivale të rëndësishme e veprës së mëparshme e regjisorit

është një pikë kyç në distribucionin e filmit shqiptarë nëpër botë. Festivalet e kategorisë A, janë vitrina më e mirë për t'ju qasur audiencës dhe kritikës ndërkombëtare. Pjesëmarrja në këto festivale është një sfidë e madhe për filmat shqipfolës duke marrë parasysh konkurrencën e madhe ndërkombëtare me të cilën duhet të përballen.

- c. Çmimet që ka fituar filmi i mëparshëm përbëjnë garancinë thuajse absolute që vepra e re regjisorit do të ndiqet me interes nga kritika ndërkombëtare dhe mundësia për të qënë pjesëmarrës me veprën e ardhshme në festivale të rëndësishëm të kategorisë A është më e madhe. Madje do të shkonim larg në propozim: Nëse regjisorin ka një çmim të rëndësishëm ndërkombëtar financimi i veprës së ardhshme të bëhet automatik.

Pikëzimi të kuotave në vlerësimin e çdo anëtari të KMP duhet të meritojë secili nga elementët e mësipërm:

Pika a. 5 pikë

Pika b. 10 pikë

Pika c. 25 pikë

II. Cilësia e skenarit konkurrues.

- a. Konfirmohet se skenari ka fituar zhvillim projektin në Programin Media;
- b. Konfirmohet se skenari është selektuar në një workshop për zhvillim skenari;
- c. Konfirmohet se skenari ka fituar një çmim në vlerë monetare;
- d. Konfirmohet se skenari ka fituar një çmim honorifik.

Argumentimi:

Skenari si hallka më e rëndësishme e veprës së ardhshme meriton një vëmendje të veçantë në vlerësim dhe zhvillim. Jo rrallë herë kemi patur projekte të miratuara nga KMP, të cilat nuk kanë qënë të zhvilluara sa duhet, e nuk kanë patur një qasje ndërkombëtare e si rrjedhojë një produkt aspak cilësor. Nëse zbërthejmë me kujdes statistikën e QKK për filmat e prodhuar në 20 vite që nga themelimi i QKK, të gjitha ato projekte të cilat kanë patur sukses ndërkombëtar kanë qënë skenarë dhe projekte të cilat janë zhvilluar në forume dhe workshope prestigjioze ndërkombëtare. Kjo për vetë natyrën e zhvillimit të skenarit si një krijim i cili duhet

të ballafaqohet që në hapat e parë me forume të ndryshme për tu përballur me sfidat e tregut ndërkombëtar.

Të gjitha pikat e sipër përmendura janë një garanci e madhe që vepra filmike e ardhshme do të jete në qëndër të vëmëndjes për festivalet më të rëndësishëm ndërkombëtarë.

Pikëzimi të kuotave në vlerësimin e çdo anëtari të KMP duhet të meritojë secili nga elementët e mësipërm:

- a. 10 pikë
- b. 5 pikë
- c. 10 pikë
- d. 5 pikë

III. Cilësia e projektit konkurrues.

- a. Konfirmohet se projekti ka fituar të drejtën për të marrë pjesë në një forum ndërkombëtar;
- b. Konfirmohet se projekti është vlerësuar me çmim në një forum ndërkombëtar;
- c. Konfirmohet se projekti është vlerësuar me çmim financiar në një forum ndërkombëtar.

Argumentimi:

Një nga fazat më delikate të realizimit të veprës filmike është konceptimi i veprës letrare skenarit në një projekt të ardhshëm filmik. Kompleksiteti më i cili do të përballë vepra e ardhshme është një nga sfidat më të vështira të prodhimit. Në këtë fazë kaq të vështirë producentet përballen me dinamika dhe vështirësi nga më të ndryshmet, si merkati, forumet, bashkëprodhuesit e ndryshëm distributorët ndërkombëtar, fondet e financimit të veprës së ardhshme filmike, bashkëpunuesit dhe stafi teknik që do realizojë veprën. Ndaj e vlerësojmë këtë fazë të zhvillimit të projektit si një nga hallkat më të rëndësishme që meriton një vëmëndje të veçantë nga KMP në vlerësimin e projektit.

Të gjitha pikat sigurojnë se projekti do të ketë një qasje ndërkombëtare dhe pika b. dhe c. tregojnë se ai ka mundësi më të mëdha suksesi edhe në festivalet ndërkombëtare, pasi shpesh forumet i bashkëmbajnë këtyre festivaleve.

Pikezim të kuotave në vlerësimin e çdo anëtari të KMP duhet të meritojë secili nga elementët e mësipërm?

Pika a. 5 pike

Pika b. 10 pike

Pika c. 15 pike

IV. Bashkërodhimi që ka siguruar projekti në momentin e aplikimit:

- a. Konfirmohet se projekti ka siguruar financimin nga fonde publike të huaja;
- b. Konfirmohet se projekti ka siguruar fonde të tjera të besueshme alternative;

Argumentitmi.

a. Projektet që cilat paraqiten pranë KMP me financime nga fonde publike të huaja të siguruar duhet të kenë një korsi prioritar. Një projekt filmik që ka thuar se të pamundur të sigurojë fonde publike nga një vend i huaj nëse me parë nuk është mbështetur financiarisht nga vendi i origjines. Jo pak herë janë financuar projekte filmike të cilat nuk kanë arritur të sigurojnë fonde publike të huaja e si pasojë kanë kaluar vështirësi në prodhimin e realizimin e filmit. Ndaj e konsiderojmë këto pike me një vlerë të vecantë e cila rrit garancinë dhe kualitetin e filmit.

b. Gjetja e fondeve alternative, e shërbimeve In-Kind apo Deferrals gjithashtu janë një garanci për realizimin dhe përfundimin me sukses të filmit. Ato i krijojnë mundësi shtesive të prodhimit të vazhdojnë punën në gjetjen e financimeve publike në vendet e bashkëprodhuesve. Kjo është një pike që reflekton qartë se projekti në fazën e paraqitjes pranë KMP ka kaluar në të gjitha hallkat e zhvillimit dhe është gati për financim.

Të dyja këto pika garantojnë cilësinë dhe përfundimin me sukses të projektit dhe shpërndarjen e filmit në më shumë vende.

Pikezim të kuotave në vlerësimin e çdo anëtari të KMP duhet të meritojë secili nga elementët e mësipërm:

Pika a. 25 pike

Pika b. 10 pike

V. Projekti duhet të gëzojë avantazh (pasi garanton sukses paraprak) nga përfshirja në të e profesionistëve që i janë bashkëngjitur si më poshtë:

- a. Drejtor fotografie të nivelit të lartë;

- b. Kompozitor të nivelit të lartë;
- c. Aktorë të nivelit të lartë kombëtar, apo ndërkombëtar.

Argumentim:

Pjesmarrja e figurave të rëndësishme krijuese në projekt, garanton një veper artistike të niveleve të larta. Kjo mund të ketë një vëmendje të veçantë në veprat e para dhe të dyta por pa lene menjane edhe veprat e karrieres. CV e këtyre figurave meriton vlerësimin nga KMP si një garanci për kualitetin artistik të filmit.

Pikezim të kuotave në vlerësimin e çdo anëtari të KMP duhet të meritojë secili nga elementët e mësipër:

Pika a. 5pikë

Pika b. 3pikë

Pika c. 5pikë

Sugjerime të metejshme:

Të shtohet një pikë, nëse vepra ka siguruar agjent ndërkombëtar të shitjes apo distributor ndërkombëtar që do të përbënte një element të rëndësishëm që vepra ka një qasje më të madhe në tregun botëror.

Ky dokument është konsultuar dhe formuluar nga kryesia e shoqatës dhe është vënë në dijeni antarsia.

Duke ju falenderuar për vëmendjen

Me respekte

Sabina Kodra

Kryetare e Shoqatës "Albanian Woman in Audiovisual"